



## **SALILLARI sh.p.k**

**Forma juridike: Shoqëri me Pëgjegjesi të Kufizuar**

**Data e themelimit: 10 Gusht 1994**

**Numri unik i indentifikimit(NIPT): J 62903125 G**

**Selia: Ura Vajguore ,Berat**

**E-mail: info@salillari.al, tel. fix (04) 2 253 619, 274 883**



**Objekti tregtar: Sherbime ndertimi**



## **Pasqyrat Financiare Vjetore 2010**

**(Mbyllur me 31.12.2010)**

**Pasqyra financiare: Individuale(jokonsoliduara)**

**Periudha kontabel: Nga 01.01.2010 deri më 31.12.2010**

**Data e mbylljes: 10 Shkurt 2011**

**Monedha: Leke**

**Shkalla e rrumbullakimit: ne leke**



**Berat, Shkurt 2011**

## **Tabela e përmbajtjes**

|  |      |
|--|------|
| A. RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVARUR.....            | 0    |
| B. BILANCI KONTABEL.....                           | 2    |
| C. PASQYRA E TE ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE .....    | 3    |
| D. PASQYRA E FLUKSIT TE PARASE .....               | 4    |
| E. PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITALET E VETA ..... | 5    |
| F. SHENIME PER PASQYRAT FINANCIARE .....           | 6-14 |



## **Raport i Audituesit të Pavarur**

Për Ortakët e shoqërise "SALILLARI" sh.p.k  
Adresa selise: Ura Vajgurore Berat

Ne kemi audituar pasqyrat financiare bashkangjitur të shoqërisë "SALILLARI" sh.p.k, të cilat përbëhen nga bilanci kontabël i dates 31 Dhjetor 2010, pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve, pasqyra e rrjedhjes së parasë dhe pasqyra e ndryshimeve në kapitalin e vet për vitin e mbyllur ne atë date, si dhe një përmbledhje e metodave të rëndësishme kontabël dhe shënimeve të tjera shpjeguese.

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standartet Shqipëtare të Raportimit Financiar. Kjo përgjegjësi përfshin: hartimin, vënien në zbatim dhe mbajtjen e kontrollit të brendëshëm të përshtatshëm mbi përgatitjen dhe paraqitjen me sinqeritet të pasqyrave financiare pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimit; zgjedhjen dhe zbatimin e metodave të përshtatshme kontabël; dhe kryerjen e çmuarjeve kontabël të arsyeshme për rrethanat e dhëna.

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Auditimi ynë u krye në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarte kërkojnë që ne të zbatojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë e kryejmë auditimin tonë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare janë pa anomali materiale. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë evidencë auditimi rreth shumave dhe informacioneve të dhëna në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen prej gjykimit të audituesit, duke përfshirë vlerësimin e rreziqeve për anomali materiale në pasqyrat financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose të gabimit. Në bërjen e këtyre vlerësimeve të rrezikut, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendëshëm përkatës të entitetit në përgatitjen dhe paraqitjen me sinqeritet të pasqyrave financiare në mënyrë që të hartojë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit për efektivitetin e kontrollit të brendëshëm të entitetit.

Auditimi gjithashtu përfshin vlerësimin e përshtatshmërisë së metodave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të bëra nga drejtimi, si dhe për vlerësimin e paraqitjes së përgjithëshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë që evidenca e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatëshme për të dhënë bazat për opinionin tonë të auditimit.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare që ne audituam, japin një pamje të vërtetë dhe të sinqertë të pozicionit (gjëndjes) financiare të shoqërisë "SALILLARI" sh.p.k, në datën 31 Dhjetor 2010, të rezultatit financiar dhe flukseve të saj të parave për ushtrimin e mbyllur, në pajtim me Standartet Shqipëtare të Rraportimit Financiar.

**Afrim SULI**

**Ekspert Kontabël i Regjistruar**



Tiranë, më 21 Mars 2011

**Shënime për pasqyrat financiare**  
**Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2010**  
(Të gjitha balancat janë në lekë)

**1. Informacione te pergjitheshme**

"SALILLARI" sh.p.k, eshte themeluar si nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me 10 Gusht 1994 dhe gjendet e rregjistruar ne regjistrin tregtar(QKR), indentifikuar me NIPT-in J 62903125G. Kapitali rregjistruar aktualisht eshte 1.232.976.000 leke dhe zotrohet nga ortakët Pellumb Salillari dhe Isuf Ferra.

Veprimtaria kryesore tregtare e shoqerise per ushtrimin 2010 kane qene sherbimet ne fushen e ndertimit, kryesisht ne ndertimin e veprave te infrastruktures.

**2. Permbledhje e politikave kontabel**

**Bazat e perqatitjes së pasqyrave financiare**

Pasqyrat financiare janë perqatitur në përputhje me ligjin shqiptar 'Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare' dhe me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit. Ato jane perqatitur mbi bazen e parimit te kostos historike, duke e kombinuar me elemente të metodave të tjera dhe parimit te te drejtave te kostatuara. Paraqitja e tyre eshte bere ne monedhen vendase, Lekë Shqiptar ("lekë").

**Parimet kontabile më domethënëse që janë pëdorur nga shoqeria, janë si më poshtë:**

**Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre**

Mjetet monetare përfshijnë mjetet monetare në arkë, banke dhe depozitat me afat. Ekuivalentët e mjeteve monetare janë investime afatshkurtra, shumë likuide dhe të gatshme për t'u konvertuar në shumën e njohura të mjeteve monetare dhe të cilat nuk janë objekt i një rreziku domethënës të ndryshimeve në vlerë.

Flukset monetare janë hyrjet ose daljet e mjeteve monetare dhe ekuivalentët e mjeteve monetare. Veprimtari të shfrytëzimit janë aktivitetet bazë të prodhimit të të ardhurave të njësisë ekonomike dhe aktivitetet të tjera të cilat nuk janë aktivitetet investuese ose financuese. Veprimtari investuese janë blerja, dhe nxjerrja e aktiveve afatgjata dhe investime të tjera që nuk përfshihen në ekuivalentët e mjeteve monetare. Aktivitetet financuese janë aktivitetet që cojnë në ndryshime në masën dhe përbërjen e kapitalit neto të kontribuar dhe të huamarrjeve afatgjata ose aftashkurtëra nga njesia ekonomike.

Overdraftet bankare konsiderohen si financim, si flukse nga veprimtaria financiare, dhe si rrjedhim përjashtohen nga mjetet monetare dhe ekuivalentët e mjeteve monetare. Paraqitja në bilancin kontabël korespondon me mjetet monetare dhe ekuivalentët e mjeteve monetare sipas përkufizimit të mësipërm.

**Aktivet financiare afatshkurtra**

Shoqëria i klasifikon aktivet financiare në Llogari/Kërkesa të arkëtueshme nga klientët dhe në Llogari/Kërkesa të tjera të arkëtueshme. Menaxhimi vendos për klasifikimin në momentin e njohjes fillestare. Aktivet financiare paraqiten në bilanc me vlerën neto, pakesuar nga zhvlerësimi nëse ka.

Llogari/Kërkesa të arkëtueshme njihen si aktive atëherë kur njesia ekonomike bëhet palë e një kontrate dhe, si rrjedhim, ka një të drejtë ligjore për të marrë mjete monetare nga klientët e saj. Njohja fillestare e kërkesave për t'u arkëtuar nga klientët ndodh derisa mallrat ose shërbimet e porositura janë nisur për tek klienti, kanë mbërritur tek klienti ose shërbimi është kryer. Kërkesat për t'u arkëtuar vlerësohen në hyrje



me kosto dhe paraqiten në bilanc të vlerësuar me koston e amortizuar (kosto fillestare minus arkëtimet e bëra, minus zhvlerësimet nga borxhi i keq nëse ka) pavarësisht nga qëllimi i njësisë për t'i mbajtur ato deri në maturim. Një zhvlerësim për rënie vlere të të drejtave për t'u arkëtuar krijohet atëherë kur ekzistojnë rrethana që Shoqëria nuk do të jetë në gjendje që t'i arkëtojë të gjitha shumat ashtu siç ishte parashikuar në termat fillestare të kërkesave për tu arkëtuar. Konsiderohen tregues të rënies së vlerës së llogarive të arkëtueshme, vështirësi të rëndësishme financiare të debitorit, debitori ka hyrë në rrugën e falimentimit ose riorganizimit financiar, moskryerja apo vonesat në pagesa etj. Shoqëria vlerëson çdo vit mundësinë e arkëtimit të llogarive të arkëtueshme për secilin klient.

Kërkesa të tjera të arkëtueshme njihen kur njësi ka një të drejtë për të marrë mjete monetare ose përfitime në të ardhmen si pasojë e një ngjarje të ndodhur, përveç shitjes, dhe kur vlera e përfitimeve matet në mënyrë të besueshme. Kërkesat e tjera të arkëtueshme vlerësohen në hyrje dhe në bilanc me të njëjtën parime si dhe llogaritë e arkëtueshme.

#### Transaksionet me monedhat e huaja

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në lekë me kursin e këmbimit në datën e kryerjes së transaksionit. Në çdo datë bilanci, zërat monetarë të bilancit të shprehur në monedhë të huaj rivlerësohen me kursin zyrtar të këmbimit të në datën e bilancit. Diferencat nga konvertimi, fitimet ose humbjet, regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, në zërin "Të tjera të ardhura (shpenzime) financiare". Zërat jomonetarë, të shprehur në monedhë të huaj, maten në termat e koston historike dhe nuk rivlerësohen.

Kurset e këmbimit, të përdorura nga shoqëria për monedhat e huaja më kryesore, më 31.12.2010 janë 1 euro=138.77 leke dhe 1 dollar=104 leke.

#### Inventarët

Inventarët njihen, në përputhje me përcaktimet e bëra në SKK-4 "Inventarët", kur shoqëria i kontrollon apo zotëron ato ekonomikisht apo ligjërisht, kur mbart të gjitha rreziqet dhe përfitimet në lidhje me to, dhe kur kostoja matet në mënyrë të besueshme.

Në hyrje inventarët e mallrave dhe materialeve vlerësohen me koston e tyre që përfshin tërësinë e çmimeve të blerjes dhe të shpenzimeve të bëra për ti sjelle inventaret në kushte magazinimi, kur këto kosto mund të identifikohen me besueshmëri. Produktet e gatshme vlerësohen në hyrje me koston e prodhimit të tyre (duke përfshirë shpenzimet indirekte të prodhimit nëse është rasti).

Në bilanc inventarët paraqiten të vlerësuar me vlerën neto, pra më të vogël midis koston dhe vlerës neto të realizueshme. Vlera neto e realizueshme është e ardhura e parashikuar nga shitja në një periudhë normale të aktivitetit minus koston e parashikuar të shitjes.

#### Aktivet afatgjata materiale

Aktivet afatgjata materiale (AAM-të) bazohen në modelin e koston. Në bilanc, një element i AAM-së paraqitet me koston minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi. Nëse vlera kontabël e një aktivi afatgjatë material rritet, si rezultat i rivlerësimit, kjo rritje kreditohet drejtpërdrejt në kapitalet e veta nën zërin "tepricë nga rivlerësimi". Nëse vlera kontabël e një aktivi afatgjatë material zvogëlohet, si rezultat i rivlerësimit, ky zvogëlim njihet si shpenzim në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Amortizimi për të gjitha grupet, llogaritet dhe njihet me metodën e vlerës së mbetur, me norma të cilat janë të përafërta me jetegjatesinë mesatare të parashikuar të përdorimit. Toka dhe aktivet në proces nuk amortizohen. Normat e përdorura janë në ndertesa 5% të dhe për aktivet e tjera 20% të vlerës së mbetur. Në ndryshim nga një vit më parë, për vitin 2010 ndertesat amortizohen me metodën e vlerës së mbetur.

**Aktivet financiare afagjata**

Investimet afatgjata në instrumentet e kapitalit, për mungese të një çmimi tregu të kuotuar në një treg aktiv, dhe në pamundësi për të matur vlerën e drejtë me besueshmëri, janë matur me koston e blerjes së tyre.

**Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra**

Shoqëria zbaton politikën e shtyrjes të shpenzimeve të cilat do të sigurojnë të ardhura në periudhat e mëvonshme. Po ashtu ajo shpërndan shpenzimet e parapaguara në vartësi të përdorimit dhe sigurimit të të ardhurave.

**Detyrimet afatshkurtra dhe afatgjata**

Detyrimet shoqëria i klasifikon në afatshkurtra dhe afatgjata, bazuar në përcaktimet e SKK-2. Huamarrjet afatshkurtrë njihen fillimisht me vlerën e drejtë, pa përfshirë kostot e transaksionit. Huat më pas vlerësohen me koston e amortizuar. Çdo diferencë midis ripagesave dhe vlerës së shlyerjes së detyrimit, njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë periudhës së huas. Huat klasifikohen si detyrime afatshkurtra, përveç rastiit kur shoqëria ka një të drejtë të pakushtëzuar për të shtyrë shlyerjen e detyrimit për të paktën 12 muaj pas datës së bilancit kontabël.

Llogaritë të pagueshme ndaj furnitoreve dhe detyrimet e tjera tregtare, njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas në bilanc paraqiten të vlerësuara me koston e amortizuar.

Detyrimet ndaj shtetit për tatimet dhe për kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore paraqiten me shumën e tyre të llogaritur sipas kërkesave ligjore në fuqi në datën e ndërtimit të pasqyrave financiare.

Huat afatgjata vlerësohen në hyrje me kosto dhe paraqiten në bilanc të vlerësuara me koston e amortizuar. Çdo diferencë midis ripagesave dhe vlerës së shlyerjes së detyrimit, njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë periudhës së huas.

**Njohja e të ardhurave dhe shpenzimeve**

Të ardhurat dhe shpenzimet njihen sipas kontabilitetit të të drejtave të konstatuara. Të ardhurat nga shitja e mallrave dhe produkteve njihen kur i janë kaluar blerësit të gjitha rreziqet dhe përfitimet, maten me besueshmëri dhe ka siguri të mjaftueshme në marrjen e përfitimeve. Të ardhurat nga kryerja e shërbimeve njihen në varësi të fazës, në të cilën ndodhet kryerja e shërbimit në datën e bilancit dhe ardhurat dhe shpenzimet që lidhen me shërbimin mund të përlogaritet me besueshmëri. Të ardhurat vlerësohen me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, duke marrë parasysh shumën e skontimeve ose rabatet e ofruara.

Shpenzimet njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve atëherë kur ngjarja detyruese ka ndodhur dhe shoqëria pret të dalin aktive për shlyerjen e tyre në të ardhmen. Shoqëria zbaton parimin e krahasimit të të ardhurave me shpenzimet brenda të njëjtit ushtrim kontabël. Shpenzimet njihen kur kryhen dhe realizohen të ardhura prej tyre, pavarësisht nëse janë faturuar apo paguar ato.

**Tatimi mbi fitimin**

Shpenzimi për tatimin mbi fitimin përfaqëson shumën e tatimit për tu paguar për vitin ushtrimor. Tatim fitimi i pagueshem për vitin aktual bazohet mbi fitimin e tatueshem i cili ndryshon nga fitimi tregëtar që raportohet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, sepse korrektohet nga shpenzimet e

panjohura sipas legjistacionit fiskal. Norma aktuale e tatimit mbi fitimin per ushtrimin 2010 eshte 10 % aq sa ka qene ne ushtrimin e mëparshëm. Shoqëria nuk zbaton kërkesat e SKK-11 për tatimi e shtyrë.

### 3. Aktive monetare (likuiditete në arke dhe bankë)

Gjendjet e mjetet monetare ne banke dhe arke, ne leke dhe valute, ne datat 31 Dhjetor 2010 dhe 31 Dhjetor 2009 jane si me poshte:

| Emertimi i Llogarise | Monedha | Gjendja ne 31.12.2010 |           | Gjendja ne 31.12.2009 |           |
|----------------------|---------|-----------------------|-----------|-----------------------|-----------|
|                      |         | Ne leke               | Ne valute | Ne leke               | Ne valute |
| Llogari bankare      | LEK     | 348,879,895           | 0         | 140,645,931           | -         |
| Arka ne leke         | LEK     | 1,249,663             | 0         | 171,618               | -         |
| <b>Shuma</b>         |         | <b>350,129,558</b>    | <b>x</b>  | <b>140,817,549</b>    | <b>x</b>  |

Gjendjet e llogarive te likuiditeteve, në llogaritë bankare dhe në arken e shoqërisë, konfirmohen me nxjerrjet e llogarive bankare dhe inventaret fizike te monedhave. Tepricat e shprehura në monedhë të huaj, jane përkthyer ne leke duke përdorur kursin e këmbimit të dates 31.12.2010 te Bankes se Shqiperise. Diferencat e rezultuara nga rivlerësimi i likuiditeteve në valutë të huaj janë sistemuar në rezultatin financiar.

Nuk ka ndryshime në politikat kontabël të njohjes, vlerësimit dhe të konvertimit të veprimeve dhe gjendjeve të likuiditeteve ne PF-te 2010.

### 4. Aktive të tjera financiare afatshkurtra

Kerkesat e arketueshme dhe aktive te tjera financiare, ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel 2010 deklarohen si vijon:

|  | Ushtrimi i mbyllur<br>31 Dhjetor 2010 | Ushtrimi i mbyllur<br>31 Dhjetor 2009 |
|--|---------------------------------------|---------------------------------------|
| Aktive të tjera financiare afatshkurtra        |                                       |                                       |
| (i) Llogari / Kërkesa të arkëtueshme           | 2,249,630,633                         | 2,164,581,816                         |
| (ii) Llogari / Kërkesa të tjera të arkëtueshme | 16,109,320                            | 9,113,401                             |
| (iii) Instrumente të tjera borxhi              | 0                                     | 0                                     |
| (iv) Investime të tjera financiare             | 0                                     | 0                                     |
| <b>Shuma</b>                                   | <b>2,265,739,953</b>                  | <b>2,173,695,217</b>                  |

Ne "Llogari / Kërkesa të arkëtueshme " jane pasqyruar kerkesat per tu arketuar nga klientet per shitjet e shëbimeve te ndertimit dhe produkteve, te cilat nuk jane arketuar ne fund te ushtrimit. Ne kete post jane vendosur dhe vlerat e akumuluar te situacioneve te ndertimit (faturave) te apartamenteve qe shoqeria nderton per shitje me fondet e veta, si dhe kerkesa te tjera te arketueshme dhe tepricat debitore te marrdhenieve me furnitoret.

Shumat e paraqitura ne "Llogari / Kërkesa të tjera të arkëtueshme" perbehen nga teprica debitore "Shteti-tatim mbi fitimin" e 31.12.2010 per shumen 8.142.767 leke, kerkesa ndaj "SKY-2009" sh.a per shperdarjen e devidentit 3.858.398 leke dhe kerkesa te tjera per 4.278.741 leke.

Drejtimi mendon se te gjitha kerkesat do te arketohen ne nje periudhe afatshkurter me vleren e tyre nominale dhe nuk parashikon renie ne vlere.

### 5. Inventari

Gjendjet e inventarit ne fillim dhe fund te ushtrimit paraqiten:





|                               | Ushtrimi i mbyllur<br>31 Dhjetor 2010 | Ushtrimi i mbyllur<br>31 Dhjetor 2009 |
|-------------------------------|---------------------------------------|---------------------------------------|
| <b>Inventari</b>              |                                       |                                       |
| (i) Lëndët e para             | 278,142                               | 2,719,310                             |
| (ii) Prodhim në proces        | -                                     | -                                     |
| (iii) Produkte të gatshme     | 184,000                               | 184,000                               |
| (iv) Mallra për rishitje      | -                                     | -                                     |
| (v) Parapagesat për furnizime | -                                     | -                                     |
| <b>Shuma</b>                  | <b>462,142</b>                        | <b>2,903,310</b>                      |

Vlerat e inventarit të paraqitura me sipër përputhen të dhenat inventarizimeve fizike e kryer në fund të ushtrimit 2010. Veprimet ekonomike që lidhen me hyrjet e daljet janë tranzituar në llogarite e rezultatit me menyren e inventarit të përhershëm. Si politike kontabel në përcaktimin e kostos së inventarit është përdorur metoda "mesatares se ponderuar". Vlera e inventarëve të njohura si shpenzim gjatë periudhës kontabël 2010 është 907.097.785 leke.

Shuma e inventarit të paraqitur në "Lëndët e para" përfaqëson stokun e materialeve që përdoren në procesin e ndërtimit të vlerësuar me koston mesatare të ponderuar.

Ndërsa në "Produkte të gatshme" pasqyrohen produktet inerte gjendje në fund të ushtrimit, të cilat do të përdoren për shitje ose konsum të brendshëm, të vlerësuar me koston faktike të prodhimit.

Drejtimi mendon se vlera e paraqitur është vlera me e ulët mes kostos së marrjes dhe vlerës neto të realizueshme dhe nuk është nevojë për zhvlerësime të tij.


## 6. Aktivet Afatgjata

### Aktivet Afatgjata Materiale(AAM-te)

Gjendjet dhe levizjet e aktiveve afatgjata materiale në pasqyrat financiare paraqiten si vijon:

| Gjendjet dhe levizjet                   | Toka               | Ndertesa           | Makineri dhe<br>pajisje | Aktivet të tjera<br>afatgjata<br>materiale | Totali               |
|---|--------------------|--------------------|-------------------------|--|----------------------|
| <b>A Kosto e AAM-ve me 01.01.2010</b>   | 201,450,002        | 136,174,012        | 894,447,550             | 17,545,463                                 | 1,249,617,027        |
| Shtesat                                 | -                  | -                  | 26,939,656              | 7,362,292                                  | 34,301,948           |
| Pakesimet                               | -                  | -                  | (20,400,589)            | -  | (20,400,589)         |
| <b>Kosto e AAM-ve 31.12.2010</b>        | <b>201,450,002</b> | <b>136,174,012</b> | <b>900,986,617</b>      | <b>24,907,755</b>                          | <b>1,263,518,386</b> |
| <b>B Amortizimi AAM-ve 01.01.2010</b>   | -                  | 35,553,013         | 523,215,174             | 11,136,426                                 | 569,904,613          |
| Amortizimi ushtrimit                    | -                  | 5,031,048          | 76,685,544              | 3,277,984                                  | 84,994,576           |
| Amortizimi për daljet e AAM-ve          | -                  | -                  | (12,860,893)            | -  | (12,860,893)         |
| <b>Amortizimi i AAM-ve 31.12.2010</b>   | <b>-</b>           | <b>40,584,061</b>  | <b>587,039,825</b>      | <b>14,414,410</b>                          | <b>642,038,296</b>   |
| <b>C Zhvlerësimi AAM-ve 01.01.2010</b>  | -                  | -                  | -                       | -  | -                    |
| Shtesat                                 | -                  | -                  | -                       | -  | -                    |
| Pakesimet                               | -                  | -                  | -                       | -  | -                    |
| <b>Zhvlerësimi AAM-ve 31.12.2010</b>    | <b>-</b>           | <b>-</b>           | <b>-</b>                | <b>-</b>                                   | <b>-</b>             |
| <b>D Vlera neto e AAM-ve 01.01.2010</b> | 201,450,002        | 100,620,999        | 371,232,376             | 6,409,037                                  | 679,712,414          |
| <b>E Vlera neto e AAM-ve 31.12.2010</b> | <b>201,450,002</b> | <b>95,589,951</b>  | <b>313,946,792</b>      | <b>10,493,345</b>                          | <b>621,480,090</b>   |

Si politike kontabel për kontabilizimin dhe shpjegimin e AAM-ve, shoqëria ka zgjedhur modelin e kostos (SKK-5). Vlerësimi fillestar në momentin e marrjes në inventar është bërë me koston e marrjes dhe në datën e mbylljes së bilancit paraqiten me koston e tyre minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi.



Vlerat dhe klasifikimi ne grupe i AAM-ve te pasqyruara ne bilanc dhe ne tabelen e mesiperme jane te perputhura me e dhenat e inventarizimeve fizike qe shoqeria e ka kryer ne fund te muajit dhjetor 2010. Drejtimi mendon se pergjithesisht per kete ushtrim kontabel, nuk ka shenja te renjes ne vlere te AAM-ve dhe nuk ka llogaritur zhvleresime.

Metodat dhe normat e amortizimit te AAM-ve te perdorura jane njejt me ato qe perdoren per qellime fiskale.(shih shenimin nr.2).Masa e llogaritur e amortizimit si shpenzim nuk i tejkalon kufijte e njohur per efekte fiskale.

#### Aktivet Financiare Afatgjata

Gjendjet dhe levizjet e aktiveve te qendrushme financiare ne pasqyrat financiare paraqiten:

|                               | Ushtrimi i mbyllur<br>31 Dhjetor 2010 | Ushtrimi i mbyllur<br>31 Dhjetor 2009 |
|-------------------------------|---------------------------------------|---------------------------------------|
| Pjesmarrje ne "SKY-2009" sh.a | 42,714,000                            | 42,714,000                            |
| <b>Shuma</b>                  | <b>42,714,000</b>                     | <b>42,714,000</b>                     |

Shoqeria eshte aksionere e "SKY-2009" sh.a, shoqeri e krijuar me 23.10.2009, per menaxhimin e pjesmarrjes se saj ne shoqine "Albania Consortium" sh.a,Tirane. "Salillari" sh.p.k zoteron ne "SKY-2009" sh.a 42.714 aksione me vlere nominale 1.000 leke/aksion ose 10% te kapitalit te rregjistruar. Gjate ushtrimit 2010 "Albania Consortium" sh.a ka shperndare dividend ne shumen 8.800.000 leke e cila eshte paraqitur ne te ardhurat e ushtrimit. Vleresimi e aksioneve eshte bere me koston e blerjes se tyre,per shkak te mungeses se një treg aktiv dhe pamundesise se matjes me besueshmeri me vleren e drejtë të tyre.

#### 7. Detyrime afatshkurtera-Huamarrjet

Nuk ka hua afateshkurtera ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel 2010.

#### 8. Detyrime afatshkurtera-Huate dhe parapagimet

Huate dhe parapagimet afateshkurtera ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel 2010 paraqiten si vijon:

|  | Ushtrimi i mbyllur<br>31 Dhjetor 2010 | Ushtrimi i mbyllur<br>31 Dhjetor 2009 |
|--|---------------------------------------|---------------------------------------|
| Huatë dhe parapagimet                  | 8                                     |                                       |
| (i) Të pagueshme ndaj furnitorëve      | 1,590,563,880                         | 1,538,416,508                         |
| (ii) Të pagueshme ndaj punonjësve      | 8,066,321                             | 2,585,739                             |
| (iii) Detyrimet tatimore+sig.shoqerore | 10,679,861                            | 53,903,102                            |
| (iv) Hua të tjera                      |                                       |                                       |
| (v) Parapagimet e arkëtuara            | 290,814,903                           | 208,035,878                           |
| <b>Shuma</b>                           | <b>1,900,124,965</b>                  | <b>1,802,941,227</b>                  |

"Të pagueshme ndaj furnitorëve" pasqyron detyrimet ndaj furnitoreve per blerjen e mallrave e sherbimeve pa u likujduar ne fund te ushtrimit. Shoqeria ka pergatitur inventaret kontabel dhe shuma e llogarise sintetike eshte e barabarte me shumen e llogarive analitike te mbajtura per çdo furnitor.

Drejtimi mendon se te drejtat e furnitoreve jane te vleresuara realisht.

"Të pagueshme ndaj punonjësve" perbehet nga detyrimi i papaguar ndaj personelit ne 31.12.2010.

"Detyrimet tatimore dhe te sig.shoqerore" me 31.12.2010 perbehen nga:

- „Shteti tatim mbi vlerën e shtuar" per shumen 8.444.409 leke,
- Detyrimi per sigurimet shoqerore e shpendesore 1.539.916 leke



- Tatimi mbi te ardhurat personale 565.045 leke
- Detyrimi per renten minerare 130.548 leke

"Parapagimet e arkëtuara" perfaqesojne arketimet e pronotuesve te apartamenteve te banimit, ne baze te kontratave te porosise, per te cilet nuk eshte realizuar kontrata e shitjes dhe trasferimi i titullit te pronesie.

#### 9. Detyrime Afatgjata-Huate afatgjata

Shoqeria nuk ka hua te klasifikuara si afatgjate ne fund te ushtrimit 2010.

#### 10. Kapitalet e veta

Kapitali i rregjistruar i shoqerise, i paraqitur ne bilanc, eshte i njejte me ate te percaktuar ne statutin e shoqerise dhe vendimet e depozituara ne QKR. Me 31.12.2010 ai eshte 1.232.976.000 leke, i ndare ne 1.232.976 kuota me vlere nominale 1.000 leke /kuota. Me vendim te Asamblese se Ortakeve fitimi i vitit 2009 eshte destinuar per rritjen e kapitalit te rregjistruar per shumen 240.664.000 leke. Vendimi eshte depozituar ne QKR sipas procedurave ligjore te kerkuara dhe efektet e tij jane pasqyruar ne ekstratet e publikueshme per shoqerine.

Ne ushtrimin kontabel 2010 nuk ka ndodhur ndryshime ne raportet e zoterimit nga ortaket.

#### 11. Fitimi (humbja) e vitit financiar

##### ▪ Te ardhurat

Te ardhura e realizuara gjate ushtrimit, sipas segmenteve(kategorive) te biznesit paraqitet si vijon:

|  | Ushtrimi i mbyllur<br>31 Dhjetor 2010 | Ushtrimi i mbyllur<br>31 Dhjetor 2009 |
|--|---------------------------------------|---------------------------------------|
| <b>Te ardhurat</b>                             |                                       |                                       |
| Te ardhurat nga shitja e produkteve            | 168,309,520                           | 60,855,695                            |
| Te ardhurat nga kryerja e sherbimeve(ndertimi) | 1,538,458,195                         | 2,326,054,773                         |
| Te ardhurat nga shitja e mallrave              | 4,375,509                             | 17,755,916                            |
| Te ardhurat te tjera(AAM)                      | 5,466,000                             | 2,304,935                             |
| <b>Shuma</b>                                   | <b>1,716,609,224</b>                  | <b>2,406,971,319</b>                  |

Të ardhurat nga shitja e mallrave dhe sherbimeve jane vlerësuar me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, duke marrë parasysh shumën e skontimeve ose rabatet e ofruara, te zhveshura nga TVSH-ja.

Të ardhurat nga sherbimet e ndertimit ne apartamente banimi, jane njohur deri në masën e shpenzimeve të rikuperueshme, të njohura në kontabilitet.(Njohja dhe vleresimi jane bazuar ne SNK-8).

Paraqitja ne pasqyrat financiare e te ardhurave dhe shpenzimeve eshte bere sipas natyres se tyre.

##### ▪ Shpenzimet e veprimtarise kryesore

Konsumi i materialeve,mallrave, furniturave, punimeve e sherbimeve, te pasqyruara ne dokumentat justifikues, jane rregjistruar me shumet e paguara ose te pagueshme.

Kostoja e punesimit, page dhe sigurime shoqerore, eshte pasqyruar saktesisht si shpenzim me vleren e realizuar dhe te dokumentuar.Taksat lokale e taksa e tatime te tjera qe lidhen me biznesin jane llogaritur dhe pasqyruar ne llogarite e ushtrimit. Sipas natyres se tyre shpenzimet e ushtrimit 2010 jane treguar ne pasqyren perkatese.

Ne zerin "Shpenzime te tjera" pasqyruar ne piken 7 te Pasqyres se te Ardhurave dhe Shpenzimeve analizohen si vijon:



|                                      | Viti raportues<br>31.12.2010 | Viti paraardhës 31.12.2009 |
|--------------------------------------|------------------------------|----------------------------|
| Shpenzime te tjera                   | 0                            | 0                          |
| Furnitura,nentrajtme dhe sherbime    | -                            | -                          |
| Energji,uje,etj                      | 8,833,934                    | 5,461,951                  |
| Telefoni, internet                   | 5,064,444                    | 6,115,334                  |
| Qera                                 | 207,600                      | 632,240                    |
| Sherbime nenkontraktore              | 454,121,255                  | 894,928,516                |
| Te tjera sherbime                    | 1,179,042                    | 7,983,138                  |
| Tatime,taksa dhe derdhje te ngjashme | 13,380,839                   | 12,851,619                 |
| Shpenzime te tjera rrjedhese         | 4,644,947                    | 6,320,323                  |
| <b>Shuma</b>                         | <b>487,432,061</b>           | <b>934,293,121</b>         |

▪ **Te ardhurat dhe shpenzimet financiare**

Jane paraqitur si diference e te ardhurave me shpenzimet sipas kerkesave te standarteve.

|   | Ushtrimi i mbyllur<br>31 Dhjetor 2010 | Ushtrimi i mbyllur<br>31 Dhjetor 2009 |
|---|---------------------------------------|---------------------------------------|
| Te ardhura dhe shpenzime financiare nga pjesmarret    | 8,800,000                             | 24,795,478                            |
| Të ardhurat nga interesat 767, 667(+)                 | -                                     | -                                     |
| Shpenzimet per interesat 767, 668(-)                  | -                                     | -                                     |
| Fitimet nga kursi i këmbimi 769, 669(+)               | 8,106,829                             | 11,899,806                            |
| Humbjet nga kursi i këmbimi 769, 670(-)               | -                                     | -                                     |
| Të ardhura dhe shpenzime të tjera financiare 768, 668 | -                                     | -                                     |
| <b>Shuma</b>  | <b>16,906,829</b>                     | <b>36,695,284</b>                     |

Ne "Te ardhura dhe shpenzime financiare nga pjesmarret" eshte pasqyruar dividenti i shperndare nga "SKY-2009" sh.a ,ne shumen 8.800.000 leke, ne te cilen shoqeria jone zoteron nje pjese te aksioneve te saj.Gjithashtu ketu jane paraqitur dhe te ardhurat e rezultuara nga kembimet valutore.

▪ **Shpenzime personeli**

Numeri mesatar i punonjesve dhe pagat sipas kategorite kryesore jane si me poshte :

| Kategorite                      | Ushtrimi 2010 (000 leke) |               |                     | Ushtrimi 2009 (000 leke) |               |                     |
|---------------------------------|--------------------------|---------------|---------------------|--------------------------|---------------|---------------------|
|                                 | Numer mesatar            | Paga          | Sgurime punedhenesi | Numer mesatar            | Paga          | Sgurime punedhenesi |
| Administrator, menaxher         | 2                        | 6,000         | 339                 | 2                        | 3,600         | 388                 |
| Specialist me arsim universitar | 12                       | 10,080        | 1,683               | 12                       | 8,400         | 1,823               |
| Teknike                         | 14                       | 9,000         | 1,503               | 14                       | 9,000         | 1,953               |
| Puntor                          | 117                      | 52,164        | 8,373               | 168                      | 52,368        | 8,593               |
| <b>Shuma</b>                    | <b>145</b>               | <b>77,244</b> | <b>11,898</b>       | <b>196</b>               | <b>73,368</b> | <b>12,757</b>       |

**12. Shpenzimet e tatimit mbi fitimin**

Shpenzimet e tatimi mbi fitimin per ushtrimin kontabel 2010 dhe 2009 jane si vijon:



|   | Ushtrimi i mbyllur<br>31 Dhjetor 2010 | Ushtrimi i mbyllur<br>31 Dhjetor 2009 |
|---|---------------------------------------|---------------------------------------|
| I FITIMI NETO PARA TATIMIT                      | 164,849,097                           | 264,974,976                           |
| II SHPENZIME TE PAZBRITESHME (+)                | 6,718,643                             | 4,015,387                             |
| 1 Amortizime tej normave fiskale                | 2,073,696                             | 2,329,390                             |
| 2 Shpezime pritje e dhurime tej kufirit tatimor | -                                     | -                                     |
